



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



Nr. 56/2013

23 janar 2013

Prishtinë

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, e cila është mbajtur më 23 janar 2013, në praninë e gjyqtarëve dhe të përfaqësuesve të tjerë të EULEX-it, në bazë të nenit 22 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, ka miratuar këtë:

Mendim Juridik

Ndryshohet Mendimi Juridik Nr. 43/2013 i datës 7 janar 2013, i Mbledhjes së Përgjithshme, në atë mënyrë që të marrë parasysh shqetësimet të cilat kanë të bëjnë me dispozitat kalimtare të Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP), konkretisht lidhur me çështjen e gjyqimeve në rrjedhë e sipër dhe të rigjyqimeve.

1. Nga data 1 janar 2013, në të gjitha procedurat që janë në rrjedhë e sipër të cilat janë nisur para hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe në lëndët për të cilat është ngritur dhe është konfirmuar aktakuza si dhe në lëndët për të cilat aktakuza apo propozim akuza është ngritur por nuk është konfirmuar, zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e Kodit të ri (neni 540, 541 i KPP-së), përveç në ato raste kur tashmë ka filluar shqyrtimi gjyqësor (neni 545.1 i KPP-së).

Në procedurat penale të nisura para hyrjes në fuqi të këtij Kodi (1 janar 2013), për të cilat shqyrtimi gjyqësor tashmë ka filluar, por nuk ka përfunduar apo ka përfunduar por është kthyer për rigjykim qoftë përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike, dispozitat e kodit të vjetër zbatohen *mutatis mutandis* derisa vendimi të marrë formën e prerë. Trupi gjykues në këtë rrethanë do të jetë i përbërë vetëm nga gjyqtarë profesionistë dhe nuk do të ketë në përbërjen e vet asnjë gjyqtar porotë pasi që në ligjin e Kosovës nuk ka më dispozita lidhur me gjyqtarët porotë.

ARSYETIM

Në lëndët penale, në të cilat procedura penale ka filluar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) por nuk është ngritur aktakuza, zbatohen dispozitat e Kodit të ri në bazë të nenit 540 të KPP-së.

Sa herë që një lëndë penale është proceduar në shqyrtim gjyqësor dhe është vendosur para hyrjes në fuqi të KPP-së së re, por vendimi është anuluar pas apelimit apo mjetit të jashtëzakonshëm juridik gjatë periudhës kalimtare (para apo pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri), shqyrtimi gjyqësor mbahet në përputhje me nenin 544 dhe 545.1 të KPP-së, që do të thotë se zbatohet Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) *mutatis mutandis*. Kjo do të thotë se në këso rrethanash, trupi gjykues do të jetë i përbërë vetëm nga gjyqtarë profesionistë dhe nuk do të ketë në përbërjen e vet asnjë gjyqtar porotë pasi që në ligjin e Kosovës nuk ka më dispozita lidhur me gjyqtarët porotë.


Sa u përket të gjitha lëndëve tjera, kuptohet si më poshtë:

- Neni 545 i KPP-së konsiderohet si rregull e përgjithshme (*lex generalis*). Prandaj, i njëjti duhet të kuptohet si një rregull i përgjithshëm që nënkupton ngritjen e aktakuzës, pavarësisht nëse zbatohet Kodi i vjetër apo ai i ri.
- Lidhur me këtë, neni 541 i KPP-së konsiderohet si rregull e veçantë (*lex specialis*), i cili specifikon që Kodi i ri do të zbatohet në të cilat aktakuza është ngritur por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi (paragrafi 1) ose kur aktakuza është ngritur dhe është konfirmuar para hyrjes në fuqi të KPP-së (paragrafi 2). Të dyja rastet i referohen gjendjes faktike kur shqyrtimi gjyqësor nuk ka filluar akoma prandaj si i tillë shqyrtimi gjyqësor do të mbahet në përputhje me dispozitat e Kodit të ri.

Ky vendim është marrë njëzëri si nga gjyqtarët kosovarë të Gjykatës Supreme të Kosovës ashtu edhe nga gjyqtarët e EULEX-it dhe nuk ka pasur asnjë mendim mospajtues lidhur me këtë.

Për Gjykatën Supreme të Kosovës:

Dr. Sc. Fejzullah Hasani



Për Asambleenë e Gjyqtarëve të EULEX-it:

Charles L. Smith III

